



**DOKUMENTAT STANDARDE TË TENDERIT PËR
PROCEDURËN E HAPUR, MBI KUFIRIN E LARTË MONETAR
SHËRBIME¹²**

**“SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI, PËR SPITALIN RAJONAL
“MEMORIAL” FIER”**

Qershor 2026

¹ Në rastet e mosparashikimeve konkrete në këtë set dokumentash autoriteti /enti kontraktor do ti referohet parashikimeve të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi.

² Seti i Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurat e prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë hartohet në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze. Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet variantit të setit në gjuhën shqipe me variantin në gjuhën angleze, do të merret për bazë seti në gjuhën shqipe.

NJOFTIME

NJOFTIMI PARAPRAK I INFORMACIONIT/ NJOFTIMI PERIDIOK I INFORMACIONIT

(Për t'u Plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor nëse aplikohet)

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor;

Emri _____

Adresa _____

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

Njësi e autoriteteve vendore

Institucioni i pavarur

Të tjera

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/ent kontraktor që prokuron për nevoja
të veta

I deleguar

Organ Qendror blerës

Ofrues shërbimi

Publik

Privat

Të tjera

1.4 Emri dhe adresa e personit të kontaktit:

Personi (at) përgjegjës për prokurimin: _____

Tel/faks _____

E-mail _____

1.5 Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):

1.6 Lloji i procedurës së prokurimit: _____

1.7 Tipi i kontratës: _____

1.8 Fondi limit i përlogaritur për këtë kontratë/marrëveshje kuadër/Fondi limit i përlogaritur për këtë objekt siç është planifikuar në parashikimin buxhetor të Autoritetit/Entit Kontraktor *(në rastin e marrëveshjeve kuadër ose kontratave shumëvjeçare)* :

1.9 Kohëzgjatja e përafërt e kontratës/marrëveshjes kuadër:

1.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës/marrëveshjes kuadër dhe/ose Lotit (eve), nëse përdoren:

1.11. Lloji i Marrëveshjes Kuadër, nëse është rasti:

1.12 Kohën e përafërt për zhvillimin e procedurës së prokurimit:

1.13 Informacion tjetër që konsiderohet i dobishëm nga autoriteti/enti kontraktor: _____

NJOFTIMI I KONTRATËS

(Për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

Seksioni 1: Autoriteti/Enti Kontraktor

1.1 Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

| | |
|--|---|
| Emri: | Operatori i Blerjeve të Përqendruara |
| Adresa: | Rr. “Reshit Çollaku”, godina nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë |
| Tel/Faks: | |
| E-mail: | info@obp.al |
| Adresa e ueb-faqes: | www.obp.al |
| Personi/at përgjegjës për prokurimin: (emri, e-mail) | D.B sektori_sherbimet@obp.al |

1.2 Lloji i Autoritetit/Entit Kontraktor:

Institucion qendror

Institucioni i pavarur

Njësi e autoriteteve vendore

Të tjera

X

1.3 Kategoria e Autoritetit/Entit Kontraktor:

Autoritet/Ent kontraktor që prokuron për nevoja të veta

Organ Qendror blerës

X

Ofrues shërbimi

Publik Privat

I deleguar

Të tjera

1.4. Kontratë në bazë të një marrëveshje të posaçme midis Shqipërisë dhe një shteti tjetër:

Po

Jo

X

1.5 Kontratë që bashkëfinancohet nga një organizatë ndërkombëtare ose një institucion financiar ndërkombëtar:

Po Jo

1.6 Kontratë e rezervuar :

Po Jo

Seksioni 2: Objekti i Kontratës: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier”

2.1 Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-91502-06-26-2026

2.2 Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP):15894220-9 Ushqime për spitalet; 55321000-6 Shërbime për gatimin e vakteve

2.3 Lloji i Kontratës: “Kontratë Publike për Shërbime”

2.4 Kontrata në bazë të Marrëveshjes Kuadër:

Po Jo

2.5 Lloji i Marrëveshjes Kuadër:

Me një Operator Ekonomik

Me disa Operatorë Ekonomikë

Të gjitha kushtet janë të përcaktuara Po Jo

2.6 Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik:

Në rastin e Marrëveshjes Kuadër me një Operator Ekonomik, kur janë përcaktuar të gjitha kushtet, më poshtë të jepen arsyet e përzgjedhjes

Duke qenë se shërbimi objekt prokurimi është një shërbim që do të kryhet në mënyrë të përsëritur, të përditshme për të garantuar ushqimin si një nga të drejtat bazë të pacientëve, i cili duhet të jetë cilësor dhe i garantuar për cdo vakt, forma juridike e finalizimit të procesit të prokurimit do të jetë me “Marrëveshje Kuadër”, me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, parashikuar në nenin 52 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, në nenin 63, në pikën 1/a) të Nenit 64 të VKM së nr. 285 datë 19.05.2021 “Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Duke vlerësuar specifikën e veçantë që ka institucioni SRMF, si dhe nisur nga natyra e vecantë e shërbimit objekt prokurimi, pasi nëpërmjet saj synohet të ofrohet shërbim i pandërprerë në gatimin, transportin dhe shpërndarjen e ushqimit për pacientët e shtruar në SRMF, marrëveshja kuader me një operator ekonomik garanton vazhdimësinë pa ndërprerje dhe me cilësi të shërbimit, sipas të gjitha rregullave higjieno sanitare,

duke filluar nga lënda e parë, përgatitja, gatimi, paketimi, transporti, shpërndarja, sipas kërkesës së AK. Gjithashtu ky shërbim kryhet me ndihmën e një sërë komponentesh sic janë kuzhina, stabilimenti, materialet e imëta, mjetet e transportit, ndaj MK me një OE garanton dhe passjell cilesi me te mire te shërbimit.

Marrëveshja Kuadër më shumë operatore do të sillte vonesa, të cilat në rastin konkret do ta bënin jo efektive aplikimin e kësaj procedure, si dhe do të krijonte vështirësi, si nga ana organizative ashtu edhe nga ana funksionale. Marrëveshja Kuadër më shumë operatorë mund të krijojë standarde të ndryshme higjeno-sanitare, mund të çënojë cilësinë e shërbimit në të gjithë komponentët e saj, fragmentarizon përgjegjësinë, duke sjellë kështu vështirësi në monitorimin dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës/ave që do të lidhen.

2.7 Marrëveshje Kuadër me disa operatorë ekonomikë:

Numri i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër: ___ (Këtu, duhet të përcaktohet numri maksimal i operatorëve ekonomikë, me të cilët do të lidhet Marrëveshja Kuadër)

2.8 Kushtet që duhet të zbatohen në rastin e rihapjes së konkurrimit:

| | | |
|--|--|--|
| | | <p>Nuk do të ketë rihapje të konkursit.</p> <p>Kontrata/ kontratat do të lidhen sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor të përcaktuara në pikën 2.9 të DT, me operatorin ekonomik të suksesshëm.</p> <p>Dhënia e kontratës/ kontratave do të behet nga Autoriteti Kontraktor i përcaktuar në pikën 2.9 të DT.</p> <p>Marrëveshja kuadër do të zbatohet me dërgimin e ftesave për ofertë tek operatori ekonomik, palë në marrëveshjen kuadër.</p> <p>Në rast të lindjes së nevojës konkrete për të lidhur një kontratë brenda marrëveshjes kuadër, autoriteti kontraktor duhet që të dërgojë “ftesën për ofertë” tek kontraktuesi, duke specifikuar listën me sasi të përkatëse të artikujve.</p> <p>Autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik fitues, të japë ofertën e tij.</p> <p>Komunikimi ndërmjet autoritetit</p> |
|--|--|--|

| | | | |
|--|--|--|--|
| | | <p>kontraktor dhe operatorit ekonomik, bëhet në formë të shkruar ose elektronike (email, fax, etj.) dhe në çdo rast duhet të dokumentohet dhe të bëhet pjesë e dosjes së procedurës.</p> <p>Sasitë e parashikuara dhe të kerkuara janë vetëm sasi orientuese dhe NUK e kushtëzojnë Autoritetin Kontraktor për t'i blerë ato.</p> | |
|--|--|--|--|

2.9 Autoriteti Kontraktor/Autoritetet kontraktore ose Enti/Entet kontraktore që do të jenë palë në Marrëveshjen Kuadër: *(këtu duhet të listohen të gjitha autoritetet/entet kontraktore që do të jenë palë përfituese nga marrëveshja kuadër)*

Organi Qendror Blerës (OBP), në emër dhe për llogari të autoritetit kontraktor si vijon:

Spitali Rajonal “Memorial” Fier”

2.10 Përshkrimi i shkurtër i kontratës / Marrëveshjes Kuadër

1. Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 79,899,744.17 (shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh ose 848,102.58 (tetëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e dy pikë pesëdhjetë e tetë) EURO pa tvsh.

(Vlera në Euro është konvertuar referuar Kursit zyrtar të këmbimit zyrtar (94.21), datë 26.06.2026)

2. Në rastin kur, objekti i prokurimit përbëhet nga disa artikuj, **shumatorja e çmimeve për njësi është _____**

3. Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit

4. Kodi Output: 1234567

5. Tipi:

Investime

Kodi: _____

Vlera: _____

Shërbime **X**

Kodi: 602

Vlera: 79,899,744.17 (shtatëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e dyzet e katër pikë shtatëmbëdhjetë) lekë pa tvsh

2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës:

Kohëzgjatja në muaj ose ditë

Ose

Fillon më □□/□□/□□□□ mbaron më □□/□□/□□□□

2.11.1. Kohëzgjatja e Marrëveshjes Kuadër:

Kohëzgjatja në muaj: 48 (dyzet e tetë) muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

Ose fillon më ____/____/____ (d/m/v)

mbaron më ____/____/____ (d/m/v)

2.12 Vendi i dorëzimit të objektit të kontratës:

Në ambientet e Autoritetit Kontraktor, për llogari të së cilit organi qendror blerës zhvillon procedurën e prokurimit:

Spitali Rajonal “Memorial” Fier”

2.13 Ndarja në Lote:

Po

Jo

Është vendosur që procedura e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar” me objekt: “Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi, për Spitalin Rajonal “Memorial” Fier” të mos kryhet e ndarë në lote, pasi objekti i kontratës përbën një shërbim të integruar, që kërkon organizim, koordinim dhe përgjegjësi të unifikuar gjatë gjithë procesit të zbatimit.

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për pacientët përbën një proces të pandërprerë dhe të ndërlidhur, që përfshin planifikimin e menuve sipas dietave të përcaktuara, sigurimin e lëndëve të para, përgatitjen e vakteve në përputhje me standardet higjieno-sanitare dhe të sigurisë ushqimore, transportin dhe shpërndarjen e tyre në kohën e duhur dhe në kushtet e kërkuara. Këto procese janë funksionalisht të lidhura me njëra-tjetrën dhe kërkojnë koordinim të vazhdueshëm, ndaj realizimi i tyre nga një operator ekonomik i vetëm garanton vijueshmërinë, cilësinë dhe përgjegjësinë e plotë për shërbimin.

Ndarja e procedurës në lote do të sillte angazhimin e më shumë operatorëve ekonomikë, duke krijuar vështirësi në koordinimin e aktiviteteve, në përcaktimin e përgjegjësive në rast mospërbushjeje të detyrimeve kontraktore, si dhe në monitorimin dhe administrimin e kontratës/ave nga autoriteti kontraktor. Gjithashtu, do të rritej rreziku i mosrespektimit të afateve të përgatitjes dhe shpërndarjes së vakteve, i ndërprerjes së shërbimit, si dhe i mospërputhjes së standardeve të cilësisë dhe sigurisë ushqimore ndërmjet operatorëve të ndryshëm. Çdo problem koordinimi ndërmjet operatorëve të ndryshëm mund të ndikojë drejtpërdrejt në cilësinë e shërbimit dhe në mbarëvajtjen e aktivitetit të spitalit.

Nëse po,

2.14 Përshkrimi i shkurtër i Loteve:

(objekti dhe fondi limit për secilin Lot)

1. _____

2. _____

2.14.1 Një ofertues mund të aplikojë për:

- një Lot,
- disa Lote,
- të gjitha Lotet.

Për secilin Lot duhet të paraqitet një ofertë e veçantë.

2.14.2 Numri maksimal i Loteve për ofertues:

Specifikoni numrin maksimal të Loteve që mund t'i jepen një ofertuesi _____

2.14.3 Kriteret/rregullat që duhet të zbatohen për të përcaktuar Lotet që do t'i jepen ofertuesit:

Specifikoni kriteret për të përcaktuar Lotet që do të jepen, kur ofertuesi shpallet fitues i më shumë Loteve sesa numri maksimal i lejuar në pikën 2.14.2.

2.14.4 Kombinimi i Loteve në një kontratë/kontrata të përbashkëta (Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një Lot):

Po **Jo**

Nëse po, specifikoni grupin e Loteve që mund të kombinohen

2.15 Pranohen variantet:

Po **Jo**

2.15.1 Pranohet nënkontraktimi:

Po **Jo**

Nëse lejohet nënkontraktimi, specifikoni përqindjen e lejuar për nënkontraktim:

(nuk lejohet nënkontraktimi në një masë më të madhe se 50 % e vlerës së kontratës)

2.15.2 Autoriteti/Enti Kontraktor do të kryejë pagesa direkte tek nënkontraktori:

Po **Jo**

Shënime të tjera *(nëse vlerësohen të nevojshme nga autoriteti/enti kontraktor)*

2.16. Mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera:

Specifikoni nëse autoriteti/ enti kontraktor kërkon që detyra/punë/aspektet kritike të kontratës të përmbushen nga vetë operatori ekonomik ose nga ndonjë prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë, për të cilën ofertuesi ndalohet të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera.

Po **Jo**

Nëse po, të specifikohet detyra, puna, aspektet kritike, që ndalohet mbështetja:

Nuk lejohet përdorimi i Licencës së kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering) së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018)

2.17 Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) përdoren standardet e përgatitura nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po **Jo**

2.18. Gjatë procesit të prokurimit në fushën e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), në rast se standardet nuk janë të zbatueshme, merret një miratim paraprak nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit:

Po Jo

Seksioni 3: Informacione juridike, ekonomike, financiare dhe teknike

3.1 Sigurimi i ofertës: (e zbatueshme në rastin e procedurave të prokurimit me një vlerë më të lartë se sa prokurimi me vlerë të vogël).

Në rastin e kontratave sektoriale, enti kontraktor, në bazë të diskrecionit të tij, mund të kërkojë sigurimin e ofertës edhe për procedurat nën kufirin e lartë monetar.

Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Shuma e kërkuar e sigurimit të ofertës është **1,597,994.9 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër pikë nëntë)** Lekë ose 16,962.05 (gjashtëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e dy pikë zero pesë) Euro.

Në rastet e paraqitjes së ofertave për Lote të veçanta, vlera e sigurimit të ofertës për secilin Lot do të jetë si më poshtë:

Loti 1 _____ (shuma,monedha)

Loti 2 _____ (shuma monedha)

3.1.2 Autoriteti/ Enti kontraktor pranon vlerën e pagesës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi, në vlerë monetare në llogarinë e autoritetit/entit kontraktor:

Credins Bank

SWIFT:CDISALTRXXX

NR.LLOGARIE: 00002032030

3.1.3 Autoriteti/enti kontraktor pranon pagesën e vlerës së sigurimit të ofertës nga ofertuesi edhe në formën:

i. garancisë bankare **X**

ose

ii. nga shoqëri sigurimi të licencuara nga autoritetet kompetente **X**

3.2 Periudha e vlefshmërisë së ofertës: 150 DITË (shprehur në ditë)

Seksioni 4: Procedura

4.1 Lloji i procedurës: E hapur, mbi kufirin e lartë monetar

4.2. Është përdorur njoftimi paraprak / periodik i informacionit:

Po **Jo** **X**

Nëse Po, numri i referencës është _____

4.2.1. Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po **Jo**

Afati shkurtohet me 5 ditë, pasi është procedurë elektronike

4.3 Procedurë e rishpallur:

Po **Jo** **X**

Nëse është një procedurë e rishpallur, ju lutemi plotësoni të dhënat identifikuese të procedurës së anuluar:

a) Numri i referencës në sistemin e prokurimit elektronik të procedurës së anuluar të prokurimit _____

b) Objekti i prokurimit të procedurës së anuluar të prokurimit _____

c) Fondi limit i procedurës së anuluar të prokurimit _____ (shuma , monedha)

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A)³ **Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto** **X**

Sipas rëndësisë:

Kriteri:

³ Shënim. Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100 pikë. Në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme, kriter për shpalljen e ofertës fituese do të jetë “oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto”, ku çmimi do të ketë 20 pikë dhe propozimi teknik 80 pikë.

1. Çmimi 70 pikë
2. Kualifikimi dhe përvoja e stafit (Kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier) [0- 13] pikë
3. Qëndrueshmëria sociale dhe mjedisore për realizimin e kontratës/ave [0- 17] pikë

Argumentimi i kritereve të pikëzuara dhe mënyra e llogaritjes së pikëve:

1. Çmimi: 70 pikë

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$P_k = V_{mink} \times P_{maxk} / Ok$

P_k _____ Pikët e kriterit që vlerësohet

V_{mink} _____ Vlera më e ulët e ofruar për kriterin që po vlerësohet

P_{maxk} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Kualifikimi dhe përvoja e stafit në institucionet shëndetësore/spitale (Kuzhinier dhe ndihmës kuzhinier) [0- 13] pikë,

Argumentim: Vlerësimi me pikë për kualifikimin profesional dhe përvojën e punës në institucione shëndetësore/spitale është vendosur për të mundësuar diferencimin e ofertuesve bazuar në cilësinë e personelit që do të angazhohet në realizimin e kontratës. Duke qenë se objekti i prokurimit lidhet me ofrimin e shërbimit të ushqyerjes për pacientët e Spitalit Rajonal Memorial “Fier”, niveli i kualifikimit dhe përvoja e stafit teknik që merr pjesë drejtpërdrejt në përgatitjen e vakteve përbëjnë elementë që ndikojnë në cilësinë dhe sigurinë e shërbimit.

Ky sistem vlerësimi synon të identifikojë dhe të vlerësojë më lart ofertuesit që disponojnë personel me kualifikime profesionale dhe eksperiencë të provuar në mjedisë spitalore, duke krijuar garanci më të larta për realizimin e kontratës sipas standardeve të kërkuara. Vlerësimi është proporcional, pasi nuk kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë që plotësojnë kërkesat minimale të kualifikimit, por diferencon ofertat në bazë të nivelit të ekspertizës së personelit të propozuar.

Kualifikimi profesional i kuzhinierit dhe ndihmës kuzhinierit është i rëndësishëm për shkak se këta punonjës janë të përfshirë drejtpërdrejt në procesin e përgatitjes, trajtimit, porcionimit dhe organizimit të vakteve. Formimi profesional dhe trajnimet përkatëse kontribuojnë në zbatimin korrekt të procedurave të sigurisë ushqimore, respektimin e standardeve higjieno-sanitare, përdorimin e teknikave të përshtatshme të përgatitjes së ushqimit dhe menaxhimin efikas të proceseve të punës në kuzhinë.

Përvoja profesionale në institucione shëndetësore/spitale përbën një element cilësor shtesë, pasi ushqyerja spitalore paraqet karakteristika specifike që nuk hasen në të njëjtën masë në shërbimet e zakonshme të kateringut. Dietat e pacientëve nuk shërbejnë vetëm për plotësimin e nevojave ushqyese, por përbëjnë pjesë të kujdesit dhe trajtimit shëndetësor, duke kërkuar respektimin e kërkesave të veçanta dietike dhe nutricionale. Përvoja në spitale demonstroi njohjen praktike të procedurave të ushqyerjes spitalore, aftësinë për të punuar me kategori të ndryshme dietash, respektimin e standardeve të sigurisë ushqimore dhe zbatimin korrekt të proceseve operative në një mjedis me kërkesa të larta higjieno-sanitare.

Për rrjedhojë, kualifikimi profesional dhe përvoja në institucione shëndetësore/spitale të kuzhinierit dhe ndihmës kuzhinierit lidhen drejtpërdrejt me cilësinë e realizimit të kontratës, sigurinë ushqimore dhe

aftësinë për të garantuar ofrimin e një shërbimi në përputhje me nevojat e pacientëve dhe kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Detajimi i pikëzimit është si më poshtë:

2.1 Kualifikimi dhe përvoja e Kuzhinierit: [0- 8] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional: 0- 3 pikë

Kërkimi i diplomës profesionale siguron përmbushjen e nivelit minimal të formimit të nevojshëm për ushtrimin e profesionit të kuzhinierit, ndërsa vlerësimi me pikë i kualifikimeve shtesë synon të diferencojë ofertuesit bazuar në nivelin e ekspertizës profesionale të personelit të propozuar. Trajnimet dhe certifikimet në fushën e sigurisë ushqimore, higjienës dhe sistemit HACCP dëshmojnë njohuri të përditësuara dhe aftësi të avancuara profesionale, të cilat lidhen drejtpërdrejt me cilësinë dhe sigurinë e shërbimit.

Në kushtet e ushqyerjes spitalore, ku përgatitja e vakteve duhet të respektojë kërkesa të veçanta dietike dhe standarde të larta sigurie ushqimore, kuzhinierët me kualifikime shtesë ofrojnë garanci më të lartë për realizimin e kontratës me cilësi, siguri dhe profesionalizëm.

Kriteri vlerësohet në mënyrë proporcionale në bazë të numrit të kualifikimeve të dokumentuara, pavarësisht objektit të tyre të detajuar, me kusht që të jenë të lidhura me profesionin e kuzhinierit dhe fushat ndihmëse (ushqim, higjienë, siguri ushqimore, menaxhim kuzhine, planifikim menuje, etj.).

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Kualifikimet, trajnimet ose certifikimet që mbulojnë të njëjtën fushë kompetence, kanë përmbajtje të njëjtë ose thelbësisht të ngjashme, nuk do të merren në konsideratë më shumë se një herë gjatë procesit të vlerësimit, me qëllim shmangien e pikëzimit të shumëfishtë të të njëjtave kompetenca profesionale dhe garantimin e një vlerësimi objektiv e proporcional të kualifikimeve.

Dokumentet për verifikim:

Certifikata profesionale/trajnime që lidhen me zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, higjienën dhe sigurinë ushqimore, teknika praktike gatimi, menaxhim kuzhine, teknkologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësim për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj., apo cdo document tjetër që provon kualifikime/trajnime në fusha që lidhen me profesionin e kuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombetare apo ndërkombëtare.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Pikët për këtë kriter përlloragriten sipas formulës:

$P_k = O_k \times P_{maxk} / V_{maxk}$

V_{maxk} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

b. Përvoja (Eksperienca) e kuzhinierit në institucionet shëndetësore/spitale 0- 5 pikë

Argumentimi:

Përvoja profesionale e kuzhinierit në spitale vlerësohet si element cilësor pasi ky personel mban përgjegjësi të drejtpërdrejtë për përgatitjen e vakteve dhe dietave sipas kërkesave të përcaktuara për pacientët. Në ushqyerjen spitalore, përgatitja e ushqimit kërkon njohuri dhe aftësi specifike që tejkalojnë gatimin e zakonshëm, pasi dietat duhet të përmbushin kërkesa të veçanta dietike dhe nutricionale në funksion të gjendjes shëndetësore të pacientëve. Përvoja në spitale demonstroi aftësinë për të zbatuar në praktikë dieta terapeutike, për të menaxhuar proceset e gatimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara dhe për të garantuar cilësinë dhe sigurinë e vakteve në një mjedis me kërkesa të larta profesionale.

Duke qenë se ushqyerja spitalore përbën pjesë të kujdesit ndaj pacientit dhe ndikon në procesin e trajtimit dhe rikuperimit, niveli i përvojës së kuzhinierit lidhet drejtpërdrejt me cilësinë e rezultatit final të shërbimit. Për këtë arsye, përvoja në spitale përbën një tregues objektiv të kompetencës profesionale dhe të aftësisë për të realizuar kontratën sipas standardeve të kërkuara.

Metoda e verifikimit:

Eksperienca minimale në punë të ngjashme për kuzhinierin është 2 vite, vite të vlerësuara si përvojë minimale e domosdoshme për të garantuar menaxhimin bazë të kuzhinës. Një eksperiencë e tillë siguron stabilitet dhe njohuri mbi proceset e gatimit. Nëse kjo eksperiencë është 2 vite ose më pak, oferta nuk merr asnjë pikë.

Me 5 pikë do të vlerësohen ofertuesit të cilët do të dëshmojnë se kanë në stafin e tyre kuzhinier me përvojën më të lartë në institucionet shëndetësore/spitale, sepse përvoja më e lartë në punë tregon rritje profesionale, ekspertizë të konsoliduar dhe aftësi në optimizimin e proceseve të punës.

Dokumentet për verifikim:

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklarata e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme.
- Cv

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Për këtë kriterin zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2.2 Kualifikimi dhe përvoja e Ndhmës Kuzhinierit: [0-5] pikë, e ndarë:

a. Kualifikimi profesional: 0- 2pikë

Kualifikimi profesional:

Kriteri i kualifikimit profesional për ndihmës kuzhinierin synon të vlerësojë njohuritë dhe aftësitë profesionale që tejkalojnë nivelin minimal të kërkuar për kualifikim. Trajnimet dhe certifikimet në fushën e

higjienës, sigurisë ushqimore, HACCP dhe trajtimit të produkteve ushqimore dëshmojnë njohuri të përditësuara dhe aftësi praktike për zbatimin korrekt të procedurave të punës.

Në kushtet e ushqyerjes spitalore, ku respektimi i standardeve higjieno-sanitare dhe i kërkesave dietike është thelbësor, kualifikimet shtesë përbëjnë një tregues të aftësisë së ndihmës kuzhinierit për të kontribuar në ofrimin e një shërbimi të sigurt, cilësor dhe në përputhje me kërkesat e Autoritetit Kontraktor.

Metoda e verifikimit: Komisioni i vlerësimit do të mbështetet në dokumentet e dorëzuara nga operatori ekonomik. Pikët do të jepen në mënyrë proporcionale sipas numrit të kualifikimeve të vlefshme të konstatuara. Kualifikimet, trajnimet ose certifikimet që mbulojnë të njëjtën fushë kompetence, kanë përmbajtje të njëjtë ose thelbësisht të ngjashme, nuk do të merren në konsideratë më shumë se një herë gjatë procesit të vlerësimit, me qëllim shmangien e pikëzimit të shumëfishtë të të njëjtave kompetenca profesionale dhe garantimin e një vlerësimi objektiv e proporcional të kualifikimeve.

Dokumentet për verifikim:

Certifikata profesionale/trajnime që lidhen me gatimin profesional, zbatimin e standarteve kombëtare e ndërkombëtare, higjienën dhe sigurinë ushqimore, teknika praktike gatimi, teknologjia ushqimore dhe inovacionet në gatim, ndërgjegjësim për mjedisin dhe qëndrueshmërinë, etj., apo cdo dokument tjetër që provon kualifikime/trajnime në fusha që lidhen me profesionin e kuzhinierit dhe objektin e prokurimit, të lëshuara nga organe të akredituara/të njohura kombëtare apo ndërkombëtare.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Për këtë kriterin zbatohet formula si më poshtë:

$P_k = O_k \times P_{maxk} / V_{maxk}$

V_{maxk} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

- b. **Përvoja (Eksperiencia) e ndihmës kuzhinierit në institucionet shëndetësore/spitale**

0- 3

pikë

Përvoja profesionale e ndihmës kuzhinierit në spitale vlerësohet si element cilësor pasi ky personel është i angazhuar në zbatimin e proceseve operative që garantojnë funksionimin e rregullt të shërbimit të ushqyerjes spitalore. Përveç mbështetjes në përgatitjen e ushqimit, ndihmës kuzhinieri merr pjesë në organizimin e produkteve, përgatitjen paraprake të lëndëve të para, porcionimin, paketimin dhe sistemimin e vakteve sipas kërkesave të përcaktuara. Këto procese kërkojnë njohje praktike të procedurave të punës dhe respektim rigoroz të rregullave higjieno-sanitare.

Përvoja në spitale demonstroi aftësinë për të punuar në një mjedis me ritëm të lartë pune, ku trajtohen njëkohësisht dieta të shumta dhe ku kërkohet saktësi e lartë në ekzekutimin e procedurave operative. Personeli me eksperiencë në kuzhina spitalore ka njohuri të konsoliduara mbi organizimin e proceseve të punës dhe kërkesat specifike të këtij shërbimi, duke kontribuar në uljen e gabimeve operative, ruajtjen e standardeve të higjienës dhe garantimin e vazhdimësisë së shërbimit. Për rrjedhojë, përvoja në spitale përbën një tregues objektiv të aftësisë së personelit për të mbështetur realizimin e kontratës në mënyrë efikase dhe të besueshme.

Metoda e verifikimit:

Eksperienca minimale në punë të ngjashme për kuzhinerin është 1 vit, vite të vlerësuara si periudha minimale e nevojshme për t'u familjarizuar me: procedurat e trajtimit të produkteve ushqimore, porcionimin e vakteve, ndarjen e dietave sipas kategorive të pacientëve dhe zbatimin e rregullave higjieno-sanitare. Këto njohuri teknike nuk fitohen vetëm nëpërmjet formimit teorik, por kërkojnë praktikë reale pune. Nëse kjo eksperiencë është 1 vit ose më pak, oferta nuk merr asnjë pikë.

Me 3 pikë do të vlerësohen ofetuesit të cilët do të dëshmojnë se kanë në stafin e tyre ndihmës kuzhinier me përvojën më të lartë në institucionet shëndetësore/spitale, sepse përvoja më e lartë në punë tregon rritje profesionale, përmirëson efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit, reflekton ekspertizë të konsoliduar dhe përvojë në kushte intensive pune.

Dokumentet për verifikim:

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme.
- Cv

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Për këtë kriterin zbatohet formula si më poshtë:

$P_k = O_k \times P_{maxk} / V_{maxk}$

V_{maxk} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

3. Qëndrueshmëria sociale dhe mjedisore për realizimin e kontratës/ave [0- 17] pikë

Qëndrueshmëria sociale dhe mjedisore për realizimin e kontratës/ave, që do lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër do të vlerësohet bazuar në masat dhe angazhimet e propozuara nga ofertuesi për të siguruar ofrimin e shërbimit në mënyrë të përgjegjshme, efikase dhe me ndikim të reduktuar në mjedis. Në kuadër të këtij kriteri do të vlerësohen zgjidhjet e propozuara për parandalimin e gjenerimit të mbetjeve ushqimore, reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimeve të qëndrueshme, si dhe përshtatshmëria e mjeteve të transportit të përdorura për realizimin e shërbimit. Vlerësimi do të kryhet sipas nënkritereve dhe metodave përkatëse të verifikimit të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

1. Planveprimi i Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi [0- 5] pikë

Argumentim: Ofertuesi duhet të përpilojë një plan veprimi për parandalimin e mbetjeve ushqimore. Ky plan përfshin (por pa u kufizuar në):

- një analizë e të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore;
- kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të mëparshme apo analiza empirike profesionale);
- hartimin e strategjive për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të e

duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat, angazhim të oferteusit në projekte sociale, etj.

Kërkesa për planveprimin e Parandalimit të gjenerimit të mbetjeve nga ushqimi është një dokument kryesor në zbatimin e kontratës, i cili do ta shoqërojë deri në fund atë, pasi zbatimi i masave të tilla përbën një element të rëndësishëm në vlerësimin e cilësisë së shërbimit, duke reflektuar angazhimin për efikasitet ekonomik dhe mbrojtje mjedisore.

Parandalimi i gjenerimit të mbetjeve ushqimore përbën një masë të rëndësishme për garantimin e një shërbimi efikas, ekonomik dhe të qëndrueshëm. Në kontekstin e ofrimit të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, minimizimi i ushqimit të papërdorur ndihmon në uljen e kostove operative, përmirëson higjenën në ambientet spitalore duke shmangur rreziqet nga kontaminimi dhe redukton ndikimin negativ në mjedis. Ofruesit e shërbimit inkurajohen të paraqesin masa konkrete për planifikimin e racioneve, përdorimin optimal të lëndëve të para dhe në përputhje me parimet e prokurimit të gjelbër.

Ushqimi i hedhur përbën një burim të madh ndotjeje, pasi gjatë dekompozimit mbetjet organike çlirojnë gazra serrë, elemente të dëmshëm mjedisor.

Nga ana tjetër, duke qenë se hedhja e ushqimit ka ndikim në aspektin social e etik, inkurajimi i praktikave si dhurimi i ushqimit të paprekur (në kushte të sigurta), bashkëpunimi me OJF për mbështetjen e grupeve vulnerabël, etj., mund të ndihmojë komunitetet në nevojë. Operatore ekonomike me pervoje në dhurimin e produkteve ushqimore kanë qasje me sociale dhe ndikojnë drejteperdrejte në prokurimin e qëndrueshëm duke optimizuar shpenzimet me anë të shpërndarjes së ushqimeve për kategori sociale në pamundësi.

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

**Vlerësimi me pikë do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to.*

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

a. Cilësia e planveprimin në aspektin mjedisor: 0- 1 pikë, e ndarë si më poshtë:

- Me 1 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët në plan veprimin e tyre do të përfshijnë:
 - një analizë të të gjitha proceseve për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve ushqimore;
 - kryerjen e matjeve të sasive të mbetjeve ushqimore në mënyrë të vazhdueshme ose periodike (duke u bazuar në kontrata të mëparshme apo analiza empirike profesionale);Në rastin e kontratave të mëparshme, në planveprim operatorët ekonomikë duhet të përshkruajnë qartë të dhënat e kontratave ku bazohen.
- strategjitë për parandalimin e teprimit të ushqimeve, duke përfshirë (por jo vetëm) garantimin e ruajtjes së ushqimit në kushtet e duhura, magazinim efikas, blerje rregullisht në sasi të duhura të lëndës së parë me të cilat do të përgatiten dietat.
- Me 0 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë, të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në pikat më sipër.

b. Cilësia në aspektin social: 0-4 pikë, e ndarë si më poshtë:

- Me 1 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët kanë përvojë të mëparshme në dhurimin e ushqimit të paprekur në kushte të sigurta, apo bashkëpunimin me OJF/struktura sociale apo pjesëmarrje në projekte sociale për dhurimin e ushqimit.
Për të vërtetuar këtë nënkriter do të paraqesin kontratat/projektet/dokumentacionin provues të përvojës së tyre.
- Me 3 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë të cilët do të paraqesin planveprim, i cili do të përmbajë praktika/strategji të strukturuar dhe afatgjatë (deri në vlefshmërinë e marëveshjes kuadër) /projekte sociale për bashkëpunimin me OJF/struktura sociale, të cilat kanë në misionin e tyre mbështetjen e grupeve vulnerabël (persona në vështirësi ekonomike, familje në nevojë, fëmijë të pambrojtur, persona me aftësi të kufizuar, etj.), me qëllim dhurimin periodik të ushqimit të paprekur, duke përfshirë këtu edhe strategjitë/masat konkrete/protokollet e rrepta për ruajtjen e ushqimit deri në dhurimin e tij në kushte të sigurta higjeno-sanitare.
Për vlerësimin e këtij nënkriteri operatorët ekonomikë duhet të paraqesin plan veprimin me të gjithë elementët e këtij nënkriteri, si dhe kontratat e bashkëpunimit me OJF/struktura sociale/projektet përkatëse.
- Me 0 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë, të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përkrahur në argumentim.

Për nënkriterin 3.1 /a zbatohet formula si më poshtë:

Për këtë kriterin zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Për nënkriterin 3.1/b zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

2. Reduktimi i ambalazheve të panevojshme dhe përdorimi i paketimit të qëndrueshëm – [0-7] pikë

Argumentim: Ofertuesi duhet të zbatojë një plan për reduktimin e ambalazheve të panevojshme dhe përdorimin e paketimit të qëndrueshëm.

Ky plan duhet të përfshijë (por pa u kufizuar në):

- përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore);
- reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk çënon sigurinë e ushqimit;
- reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj.

Në kuadër të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe zbatimit të politikave të prokurimit të gjelbër, zgjedhja e llojit të duhur të paketimit gjatë blerjes së produkteve ushqimore përbën një element kyç në reduktimin e mbetjeve dhe ndikimit negativ në mjedis.

Paketimi i thjeshtë, funksional dhe i biodegradueshëm ndihmon në:

- Reduktimin e volumit të mbetjeve të ambalazhit, të cilat përndryshe përbëjnë një ngarkesë të konsiderueshme për mjedisin, zvogëlimin e përdorimit të materialeve plastike dhe ambalazheve dytësore (paketime të panevojshme brenda paketimeve), të cilat janë shpesh jo të riciklueshme dhe pa funksion real ruajtës;
- Sigurimin e ruajtjes më të mirë të produkteve ushqimore, duke garantuar jetëgjatësi më të madhe, kontroll cilësor dhe mbrojtje ndaj ndotjes apo dëmtimeve gjatë transportit dhe shpërndarjes;

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

- a. Plani i veprimit për ambalazhimin e panevojshëm dhe metodologjia e mbledhjes dhe përpunimit të këtij ambalazhi: 0-1 pikë, ndarë si më poshtë:**

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë një dokument të shkruar, ku të përfshihen përcaktimet e mësipërme, por pa u kufizuar në to.

**Vlerësimi me pikë do të bëhet duke analizuar përfshirjen e elementeve të argumentimit duke mos u kufizuar në to.*

- Me 1 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë, të cilët në plan veprimit e tyre do të përfshijnë:
 - përpilimin e inventarit të mbetjeve: duke analizuar të gjitha proceset për të identifikuar llojet dhe burimet e gjenerimit të mbetjeve të tjera (përveç mbetjeve ushqimore);
 - strategjitë/masat konkrete për reduktimin e mbetjeve në blerjen e lëndëve të para, me të cilat do të përgatiten racionet (dietat): zgjedhja e llojit të duhur të paketimit për të reduktuar mbetjet (p.sh. paketim të ripërdorshëm), paketim të riciklueshëm dhe kthimi i paketimit për ripërdorim vetëm në raste kur kjo është e mundur dhe nuk cënon sigurinë e ushqimit;
 - strategjitë/masat konkrete për reduktimin e mbetjeve në shërbimin e kateringut: shmangia e artikujve me ambalazh dytësor të panevojshëm ose të tepërt, përdorimi i kontenitorëve që mund të rimbushen (për erëza), etj.
- Me 0 pikë do të vlerësohen operatorët ekonomikë, të cilët nuk paraqesin fare planveprim ose një planveprim që nuk përmban asnjë të dhënë të përshkruar në pikat më sipër.

- b. Lloji i paketimit i zgjedhur, i cili mund të jetë i biodegradueshëm ose i riciklueshëm: 6 pikë, ndarë si më poshtë:**

Për të përmbushur këtë kërkesë operatori ekonomik, duhet të paraqesë dokumente provuese/faktike për llojin e pakteimit të zgjedhur, të cilin e ka përfshirë në planveprimin e paraqitur për nënkriterin 3/a.

Me 6 pikë do të vlerësohet operatori ekonomik, i cili për llojin e paketimit të zgjedhur (të cilin e ka përfshirë në planveprimin e paraqitur për nënkriterin 3/a do të dorëzojë:

dokumentacion faktik, siç është një marrëdhënie e dëshmuar me një prodhues apo distributor të paketimeve ushqimore. Ku marrëdhënia është me distributor të autorizuar do të vërtetohet marrëdhënia e distributorit me prodhuesin. Në aktet provuese duhet të përshkruhet natyra e paketimit nëse është e riciklueshme, e biodegradueshme apo e ndonjë lloji tjetër, miqësore me mjedisin.

Nëse për këtë nënkriter nuk paraqitet asnjë dokument provues/faktik që të vërtetojë se paketimi i propozuar i përfshirë në planveprimin e paraqitur për nënkriterin 3/a nuk ka elemente pro mjedisore vlerësohet me 0 pikë.

Për nënkriterin 3.2 /a zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

Për nënkriterin 3.2 /b zbatohet formula si më poshtë:

$$P_k = O_k \times P_{\max k} / V_{\max k}$$

$V_{\max k}$ _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

$P_{\max k}$ _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

3. Mjetet e Transportit [5 pikë]

Argumentim: Ofertuesi duhet të dëshmojë se shërbimi i transportit të ushqimit deri në ambientet e AK, do të realizohet me mjete transporti frigoriferike (N1/N2) me emetime zero/të ulëta të ndotësve të gaztë.

Shërbimi i gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit për SRMF është një proces i përditshëm, me frekuencë të lartë shpërndarje, përdorim të mjeteve transportuese dhe konsum të konsiderueshëm energjie, duke sjellë ndikime direkte në mjedis.

Kërkesa për përdorimin e mjeteve frigoriferike me emetime të ulëta të ndotësve të gaztë kontribuon jo vetëm në uljen e ndotjes në mjedisin ku këta mjete qarkullojnë, por edhe në zvogëlimin e ndotjes globale dhe përmbushjen e objektivave të klimës. Automjeti i propozuar do të lëvizë minimalisht tre herë në ditë për shpërndarjen ushqimore, kështu që frekuenca e lëvizjes dhe ndotja është relativisht e lartë. Për këtë arsye, automjetet me emetime të ulëta të ndotësve të gaztë janë më miqësore me mjedisin.

Për të përmbytur këtë kërkesë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- certifikatë të regjistrimit të mjetit me të dhënat teknike /leje qarkullimi ku pasqyrohet standarti EURO. Në rastet kur në këto dokumente nuk është i shënuar standarti EURO, të paraqitet dokument i lëshuar nga prodhuesi, apo dokument tjetër i lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore, në të cilat pasqyrohen kjo e dhënë.

Vlerësimi do të bëhet si më poshtë:

Përdorimi i mjeteve të transportit me emetime të ulëta të ndotësve të gaztë është një element i rëndësishëm i prokurimit të gjelbër, i cili kontribuon në mbrojtjen e mjedisit, uljen e ndotjes së ajrit dhe përmirësimin e shëndetit publik.

Për këtë arsye është vendosur një sistem pikëzimi i diferencuar, i cili vlerëson në mënyrë proporcionale operatorët ekonomikë që përdorin mjete miqësore me mjedisin.

Mjetet me emetim jo më të vogël se EURO 6 kane kufij shumë më të rreptë për oksidet e azotit, duke I reduktuar deri në 80 % krahasuar me Euro 5. Standarti jo më i vogël se Euro 6 kufizon ndjeshëm grimcat e imëta dhe ka norma të reduktuara të emetimit për ndotësit e gaztë, duke përmbushur kështu dispozitat ligjore në fuqi për qarkullimin e mjeteve dhe direktivat e BE për ndotjen e ajrit. Për të gjitha sa më sipër, janë vlerësuar me 5 pikë.

Mjetet me emetim EURO 5 apo më të vogël se Euro 5 kanë nivele më të larta ndotjeje (NO₂, CO dhe grimca të ngurta), dhe kanë impakt më të ulët në përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe uljen e ndotjes në mjedis se mjetet e cituara më sipër. Për këtë arsye vlerësohen në mënyrë proporcionale sipas formulës përkatëse.

Pikëzimi është vlerësuar i tillë me qëllim mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga shkarkimet e ndotësve të gaztë prej mjeteve motorike, mbështetur në VKM nr. 633 datë 26.10.2018 “Për masat kundër ndotjes së ajrit nga shkarkimet e mjeteve motorike dhe reduktimin e shkarkimeve në ajër të ndotësve të gaztë dhe të lëndës së ngurtë pezull nga motorët me ndezje pozitive dhe ata me ndezje me kompresion që djegin gaz natyror apo të lëngshëm për përdorim në automjete”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 6 datë 12.11.2021 “Mbi kontrollin Teknik të mjeteve rrugore”.

Në pikën 4, gërma 4 të VKM nr. 633 datë 26.10.2018, i ndryshuar, termi “Ndotës të gaztë”, janë shkarkimet e gazta të monoksidit të karbonit (CO), oksideve të azotit të shprehura si ekuivalent i dyoksidit të azotit (NO₂) dhe hidrokarbureve në total (THC), përfshirë lëndë të ngurta pezull (PM).

Kriteret e vendosura janë hartuar sipas kuadrit ligjor dhe metodologjik të udhërrefyesit të APP-së për prokurimin e gjelbër.

Për nënkriterin 3.3 zbatohet formula si më poshtë:

$P_k = O_k \times P_{maxk} / V_{maxk}$

V_{maxk} _____ Vlera më e lartë e ofruar për kriterin që vlerësohet

P_{maxk} _____ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_k _____ Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet.

OSE

B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të vlerësuar).

4.5 Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave:

Data: **29/07/2026** (d/m/v) ora **11:00**

Vendi: www.app.gov.al.

Kur oferta kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, ofertuesit duhet ta paraqesin atë në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP, www.app.gov.al.

Informacioni mbi ofertat e paraqitura në mënyrë elektronike i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë paraqitur oferta, me kërkesë të tyre.

4.6 Aplikohet shkurtimi i afatit për pranimin e ofertave, sipas parashikimeve në nenin 42, pika 6, të LPP (e aplikueshme për procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar).

Po

Jo X

Nëse po, argumentoni arsyet e shkurtimit të këtij afati:

| |
|--|
| |
|--|

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Mbi çdo ambalazh me djathë të grirë vendoset etiketa në të cilën shënohenP:

Origjina e produktit

Emri tregtar

Përbërësit:

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadencës

Sasia neto e produktit

Udhëzimet e përdorimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë

Marrja në dorëzim e shkatërrimit të grirës bëhet me lote. Lot quhet sasia e produktit e prodhuar në kushte të njëjta, me datë prodhimi dhe datë skadence, dhe që dorëzohet njëherësh.

Raport- analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike e paraqitur duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Transporti dhe Ruajtja

Të ruhet në temperaturë 2-5°C, në ambiente të pastra dhe me lagështi relative të përgjithshme. Transporti duhet kryhet me mjete frigoriferike dhe në kushte higjienike-sanitare të përgjithshme për transportin e produkteve ushqimore, të miratuara nga autoriteti i kontrollit (AKU).

76-DJATHË PA KRIPË

Bazuar në SSH 1492:1987 ose ekuivalentin e tij.

Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë nr. 15, datë 09.09.2021 "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore".

Klasifikimi

Lloji: lope, dele ose dhie

Kërkesat cilësore

Treguesit shqisorë:

Pamja e jashtme: E pastër, pa dëmtime mekanike, pa myk dhe pa prani trupash të huaj. Në prerje paraqet strukturë homogjene dhe kompakte.

Era dhe shija: Të ketë erë dhe shije karakteristike të këndshme të djathit të freskët, pa shije të hidhur, acide, djegëse ose aromë të huaj.

Forma dhe masa: Formë kubi, paralelopipedi ose ushqim kërkimës së AK-së. Masa sipas kërkesës së AK-së

Konsistenca: E butë deri në mesatarisht e fortë, homogjene, pa shtresim dhe pa thyerje të tepruar.

Ngjyra: E bardhë deri në krem të hapur, uniforme në të gjithë masën.

Treguesit fiziko-kimik:

Lëndët e thata në % jo më shumë se 45.

Yndyra në lëndë të thata në % jo më shumë se 30.

Kripë në % 0.

Aciditeti dhe lagështia sipas standardit përkatës të prodhimit.

Treguesit mikrobiologjikë:

Ngarkesa mikrobike brenda normave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr. 15, dt. 09.09.2021 "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore".

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produkteve, sipas Vendimit Nr. 434, datë 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", me masën e përcaktuar sipas AK-së.

Mbi çdo ambalazh me djathë pa kripë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Origjina e produktit

Emri tregtar

Përbërësit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadencës

Sasia neto e produktit

Udhëzimet e përdorimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësië

Marrja në dorëzim e djathit bëhet me lote. Lot quhet sasia e produktit e prodhuar në kushte të njëjta, me datë prodhimi dhe datë skadence, dhe që dorëzohet njëherësh.

Raport - analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike e paraqitur duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Transporti dhe Ruajtja.

Të ruhet në temperaturë 2-4°C dhe në kushte higjieno-sanitare të përshtatshme. Transportimi kryhet me mjete frigoriferike të miratuara nga autoriteti i përgjegjës (AKU), duke garantuar ruajtjen e cilësisë dhe sigurisë ushqimore të produktit.

77-DJATHË I NJOMË

Bazuar në SSH 1492:1987 ose ekuivalentin e tij

Bazuar në Udhëzimin e Ministrisë së Bujqësisë nr. 15, dt 09.09.2021 "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore".

Klasifikimi

Lloji: lope, dele ose dhie

Kërkesat cilësore

Treguesit Shqisorë:

Pamja e jashtme: E pastër, pa myk, pa dëmtime dhe pa prani trupash të huaj. Në prerje paraqet strukturë homogjene me lagështi karakteristike të djathit të njome.

Era dhe shija: Të ketë erë dhe shije të freskët e karakteristike të djathit të njomë, pa shije të hidhur, të thartë të theksuar ose aromë të huaj.

Forma dhe masa: Formë kubi, cilindrike ose sipas kërkesës së AK-së. Masa sipas kërkesës së AK-së.

Konsistenca: E butë, homogjene, lehtësisht elastike dhe pa shtresa.

Ngjyra: E bardhë deri në krem të hapur, uniformë në të gjithë masën.

Treguesit fiziko-kimik:

Lëndët e thata në % jo më shumë se 40.

Yndyra në lëndë të thata në % jo më shumë se 28.

Kripë në % jo më shumë se 3±1.

Lagështia sipas standardit të prodhimit.

Treguesit mikrobiologjikë:

Ngarkesa mikrobike brenda normave sipas Udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë nr. 15, dt. 09.09.2021 "Mbi kriteret mikrobiologjike për produktet ushqimore".

Ambalazhimi dhe etiketimi

Ambalazhimi duhet të sigurojë cilësi higjienike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptike të produkteve, sipas Vendimit Nr. 434, datë 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", me masën e përcaktuar sipas AK-së.

Mbi çdo ambalazh me djathë të njomë vendoset etiketa në të cilën shënohen:

Origjina e produktit

Emri tregtar

Përbërësit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadencës

Sasia neto e produktit

Udhëzimet e përdorimit

Kushtet e veçanta të ruajtjes
Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësië

Marrja në dorëzim e djathit bëhet me lote. Lot quhet sasia e produktit e prodhuar në kushte të njëjta, me datë prodhimi dhe datë skadence, dhe që dorëzohet njëherësh.

Raport - analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike e paraqitur duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Transporti dhe Ruajtja.

Të ruhet në temperaturë 2-4°C, në ambiente të pastra dhe me lagështi relative të përshtatshme. Transportimi duhet të kryhet me mjete frigoriferike dhe në kushte higjieno - sanitare të përshtatshme për transportimin e produkteve ushqimore, të miratuara nga autoriteti përgjegjës (AKU).

78-BUKË GRURI PA KRIPË

Bazuar në SSH 1411:1987 ose ekuivalentin e tij

Klasifikimi:

Bukë me miell gruri pa shtim kripe

Karakteristikat cilësore:

Treguesit shqisorë:

Korja: E lëmuar, pa djegie dhe pa shëputje nga tuli. Me ngjyrë të njëtrajtshme mjalti deri në të kuqërremtë të lehtë.

Tuli: Masë e njëtrajtshme, e pjekur mirë, jo ngjitëse, me pore të shpërndara në mënyrë uniforme dhe pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistencë elastike, që rikthehet në gjendje e mëparshme pas shtypjes së lehtë.

Era dhe shija: E këndshme dhe karakteristike e bukës së freskët, pa shije ose aromë të huaj. Nuk lejohet kërcitje.

Lëndët e huaja: Nuk lejohen.

Proteinat: Mbi 12.5%.

Treguesit fiziko-kimik:

Lagështira në tul, % jo më shumë se 44.5.

Poroziteti në % jo më pak se 72.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 4.5.

Kripa në % 0

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Çdo bukë të ambalazhohet me materiale të përshtatshme sipas Vendimit Nr. 434, dt 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", me masën e përcaktuar sipas AK-së.

Në etiketë duhet të shënohen:

Emri i produktit

Përbërësit

Pesha neto

Data e prodhimit

Data e skadencës

Kushtet e ruajtjes

Emri dhe origjina e prodhuesit

Ruajtja dhe transportimi:

Bazuar në SSH 1494:1987 ose ekuivalentin e tij.

Buka e pjekur ruhet në mjedise të pastra, të ajrosura, pa lagështirë dhe të dezinfektuara nga dëmtuesit.

Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 48 orë.

Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Të paraqitet raport – analizë për lotin përfaqësues të grurit/miellit cdo muaj dhe për 1 kampion buke.

Ky testim vlen për të verifikuar karakteristikat fiziko-kimike të produktit, AK-së i lind e drejta ta reklamojë këtë shmangie të autoritetit përgjegjës për cilësinë dhe sigurinë ushqimore (AKU), i cili kryen analiza për verifikimin e cilësisë.

Të paraqitet raport-analizë cdo muaj gjatë lëvrimit të mallit.

Raport- analiza fiziko – kimike e paraqitur duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe duhet të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

79-ORIZ/MAKARONA PA PROTEINË

Bazuar në SSH 1170:1987 ose ekuivalentin e tij.

Klasifikimi:

Produkte dietike me përmbajtje shumë të ulët proteinash.

Sipas llojit:

Oriz pa proteinë

Makarona pa proteinë

Sipas formës së makaronave:

Spageti

Spirale (Fusili)

Figura të ndryshme

Peta, sharrë, etj.

Kërkesat cilësore:

Treguesit shqisorë:

Pamja: Produktet të jenë me formë të rregullt, të plota, me sipërfaqe të lëmuar ose lehtësisht të ashpër.

Lejohen përkulje ose plasaritje të vogla pa cënuar cilësinë. Pas zierjes së tyre elastike, të mos qullohen dhe të mos shpërbëhen.

Ngjyra: E bardhë deri në krem të hapur ose me nuancë të verdhë të lehtë, karakteristike e produktit pa proteina.

Era dhe shija: Të këndshme dhe karakteristika të produktit, pa shije të hidhur, të thartë, të mykur ose aromë të huaj.

Treguesit fiziko-kimik:

Lagështia jo më shumë se 13%.

Aciditeti si acid sulfurik, në %, jo më shumë se 0.16%.

Përmbajtje e proteinës: jo më shumë se 1%.

Pa gluten ose me përmbajtje gluteni sipas standardeve për produktet dietike me përmbajtje të ulët proteinike.

Ambazhimi dhe etiketimi

Ambalazhi duhet të sigurojë cilësi higjenike, ushqimore, teknologjike dhe organo-leptikës së produktit, sipas Vendimit Nr. 434, datë 11.7.2018 "Për etiketimin e ushqimeve dhe informacionin e konsumatorit".

Në çdo ambalazh vendoset një etiketë ku shënohet:

Origjina e produktit

Emri i prodhuesit
Emërtimi i produktit
Pesha neto ose vëllimi i produktit
Data e prodhimit
Data e skadencës
Temperatura e ruajtjes së produktit
Udhëzimet e prodhimit
Kushtet e ruajtjes
Përmbajtja e proteinave dhe informacioni dietik

Ruajtja dhe transportimi:

Produktet ruhen në ambiente të pastra, të thata, të ajrosura dhe të painfektuara, në temperaturë deri në 20°C, me lagështi relative të ajrit deri në 70%. Jetëgjatësia e produktit përcaktohet sipas datës së skadencës të vendosur në etiketë.

Transportimi kryhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga faktorë atmosferikë, duke zbatuar rregulat higjeno-sanitare për transportimin e produkteve ushqimore, të mbuluara dhe të destinuara për transportin e artikujve ushqimorë sipas legjislacionit në fuqi.

Verifikimi i kërkesave të sigurisë dhe cilësisë

Marrja në dorëzim bëhet me lot malli. Lot konsiderohet sasia e produktit të të njëjtit lloj, me karakteristika të njëjta, të prodhuara nga i njëjtit prodhues dhe të dorëzuara njëherësh me datë prodhimi dhe datë skadene të përcaktuar.

Karakteristikat fizike-kimike dhe përmbajtja e proteinës duhet të jenë të pasqyruara në etiketë.

Raport-analiza fizike-kimike duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe të përmbajë të gjithë tregimet e mësipërm.

80-BUKË MISRI

Bazuar në SSH për produkte të bukës ose të ekvivalentin e tij.

Klasifikimi:

Bukë me miell misri.

Kërkesat cilësore:

Treguesit shqisorë:

Korja: e pjekur mirë, e njëtrajtshme, pa djegie dhe pa shkëputje nga tuli. Me ngjyrë të artë në të verdhë-kafe.

Tuli: masë e njëtrajtshme, e pjekur mirë, jo e ngjitshme, me pore të shpërndara në mënyrë të njëjlojtë dhe pa gjurmë mielli të pabrumosur. Konsistencë e butë dhe elastike.

Era dhe shija: Karakteristike dhe e këndshme për bukën e misrit, pa shije apo erë të huaj. Nuk lejohet kërcitje.

Lëndët e huaja: Nuk lejohet.

Ngjyra e tulit: E verdhë natyrale karakteristike e miellit të misrit.

Treguesit fiziko-kimik:

Lagështira në tul, % jo më shumë se 45.0.

Poroziteti në % jo më pak se 68.

Aciditeti në gradë jo më shumë se 5.0.

Kripa në % jo më shumë se 2.0.

Proteinat, % jo më pak se 7.0.

Ambalazhimi dhe etiketimi:

Bazuar ne SSH përkatës ose ekuivalentin e tij

Çdo bukë të ambalazhohet me materiale të përgjithshme sipas vendimit Nr. 434 datë 11.7.2018 "Për tikitimin e ushqimeve dhe informimin e konsumatorit", me masën e përcaktuar sipas AK-së.

Ruajtja dhe transportimi:

Buka e pjekur ruhet në ambiente të pastra, të ajrosura, pa lagështirë dhe të dezinfektuara nga dëmtuesit.

Koha e ruajtjes në këto kushte është deri në 48 orë.

Transportimi bëhet me mjete të pastra, të mbrojtura nga dëmtimet dhe faktorët atmosferikë, duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare për transportin e produkteve ushqimore.

Verifikimi I kërkesave të sigurisë dhe cilësisë:

Të paraqitet raport-analizë për lotin përfaqësues të miellit të misrit çdo muaj dhe për 1 kampionat buke.

Raport-analiza duhet të verifikojë karakteristikat fizike-kimike të lëndës së parë dhe produktit.

Në rast konstatimi të parregullsive në karakteristikat fiziko-kimike të produktit, AK-së i lind e drejta të reklamojë këtë shmangie pranë autoritetit përgjegjës për cilësinë dhe sigurinë ushqimore (AKU).

Raport- analiza fiziko – kimike duhet të kryhet në laborator të akredituar dhe të përmbajë të gjithë treguesit e mësipërm.

Kapaciteti i kuzhinës duhet të jetë i tillë që të prodhojë 400 racione në vakt, me detyrim për efekt të emergjencave civile.

Operatori ekonomik përgatit ushqimin në mënyrë të përqëndruar në kuzhinë çdo ditë në bazë të numrit të të shtruarve bazuar sipas përcaktimeve të dietave të kartelës së pacientit, vënë nga mjeku kurues përkatës, si dhe të personelit mjekësor që është në shërbim 24 orë.

Në të gjitha rastet dhe për të gjitha vaktet, llogaritja e racioneve sipas dietave bëhet nga Komisioni i Monitorimit të Kontratës, çdo ditë.

Çdo ditë, kryeinfermieri në bashkëpunim me shefin e shërbimit, harton forcën ditore totale për pacientët e shërbimit dhe brenda orës 12:00 e dërgon pranë Komisioni i Monitorimit të Kontratës (në rastet kur kemi shtrime pas orës 12 :00 njoftohet operatori për shtimin e forcës).

Kjo forcë do të shtohet vetëm për vaktet kur pacienti mer shërbimin.

Komisioni i Monitorimit të Kontratës, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë kërkesat ditore sipas racioneve apo dietave duke shtuar dhe numrin e personelit mjekësor që trajtohet me ushqim gjatë shërbimit 24 orësh.

Kontraktuesi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin mjekësor që është në shërbim 24 orësh në vendin që do të caktohet për këtë qëllim.

Makineritë, pajisjet dhe materiali i imët dhe ndihmës si për kuzhinën dhe për pavionet do të sigurohen nga kontraktuesi, i cili do të përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.

Pasqyra përmbledhëse e përgatitur nga Komisioni i Monitorimit të Kontratës, i dorëzohet përgjegjësit të kuzhinës së operatorit ekonomik çdo ditë brenda orës 13:00, e cila shërben si porosi për ditën e nesërme.

Transporti i ushqimit të përgatitur në kuzhinën kryesore deri në pavion dhe më tej tek pacienti, realizohet nga operatori ekonomik me enë të posaçme (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasië që ofrohet si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit dhe temperaturës. Ushqimet dorëzohen nga kontraktuesi në minikuzhinat e pavioneve në varësi të kontraktuesit duke shpërndarë ushqimin deri tek shtrati i pacientit, për ta tërhequr më pas, pas një ore.

Të gjitha termuset dhe enët që transportohet ushqimi duhet të jenë detyrimisht me material inoxi dhe mbyllje hermetike për të ruajtur produktet nga agjentet atmosferike.

Ushqimet duhet të përgatiten në racione individuale sipas dietave të përcaktuara nga mjeku.

Këto racione duhet të përgatiten në minikuzhina dhe të shpërndahen me karrela të lëvizshme me kate, të vendosen në tabaka të veçanta sipas dietave për çdo pacient. Ky ushqim duhet të serviret detyrimisht i mbuluar me qese plasmasi (rulon), për të ruajtur higjienën kulinare.

Ushqimet e përgatitura në racione individuale sipas porosisë së një dite më parë, të shpërndahen në pavione, si më poshtë:

- 3 herë në ditë për pacientët adultë:

Mëngjesi, 07:00-08:00;

Dreka, 12:00-13.00;

Darka, 18:00-19:00;

Në dispozicion të sipërmarrësit do të jete nje dhome/ambient ,e cila do të jepet konform ligjit dhe direktivave përkatëse ligjore. Kjo dhomë/ambient përdoret për të mbajtur inventarin e të gjitha llojeve të enëve që nevojiten për shpërndarjen e ushqimit deri tek pacienti.

Baza material për shpërndarjen e ushqimit për secilin pacient si dhe për minikuzhinat sigurohet nga sipërmarrësi.

Sipërmarrësi brenda sipërfaqeve të përcaktuara realizon ruajtjen, pastrimin dhe desinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren brenda në pavion.

Sipërmarrësi në këto ambiente konsumon ujë dhe energji elektrike për të cilat duhet të bëjë pagesat përkatëse sipas matësave që do t'i vendosë brenda këtyre ambienteve.

Enët që përdoren për shpërndarjen e ushqimit tek pacienti duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin. Ato nuk duhet të jenë absolutisht plastike.

Ushqimet si kosi, gjalp, reçeli, etj., duhet të jenë detyrimisht të paketuara me ambalazh njëpërdorimsh.

Sipërmarrësi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin që është në shërbim 24 orësh.

Materiali njëpërdorimsh dhe materialet larëse mbulohe nga kontraktuesi.

Personeli mjekësor konsumon ushqimin në mensën e kuzhinës, këtu bën përjashtim personeli që është në shërbim urgjence dhe reanimacion, të cilët e marrin pranë vendit të punës, të pakeluar sipas standardeve.

Ngarkesa e personelit që kryen shpërndarjen e ushqimit në pavione është e ndryshme nga një pavion në tjetrin, sipas specifikave:

- Numri i shtretërve;
- Veçoria e të sëmurit; të sëmurë rëndë etj.

Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me mirëkuptim të SRMF.

Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtimit të profesionit të tij.

Punonjësit duhe të sillen me edukatë dhe kortezi si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të SRM.

Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, tu kryhet pagesa e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriati Sanitar Shëndetësor.

Sigurimi i të gjitha artikujve ushqimore do të jetë sipas kalorive përkatëse të miratuara.

Llojshmëria e ushqimit do të jetë sipas sezonit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara sipas programit të menisë së përgatitur në baze të dietave dhe kalorive të konfirmuara nga mjeku dietolog.

Dietat e veçanta që nuk përfshihen në dietat e parashikuara, por që mund të kërkohen nga A.K., do të aprovohen nga mjeku kurues (dhe mjeku dietolog në rast se spitali e ka në shërbimin e tij), dhe vlerësohen nga Sektori i Monitorimit të Shërbimeve të Kontraktuara dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

Kontraktuesi do të sigurojë ushqim të sigurtë, të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e kuzhinës dhe minikuzhinave, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.

Ushqimet do të nënshtrohen kontrillit të analizave, biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standartet e të ushqyerit.

Kontraktuesi duhet të sigurojë ambjente me temperaturën e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve në kuzhinë.

Kontraktuesi merr përsipër evadimin e mbeturinave të prodhuara gjatë procesit të përgatitjes së ushqimit. Ndërsa, mbeturinat pas kosnumit të ushqimit do të depozitohen të ambalazuara dhe etiketuara në vendin që do të përcaktohet nga strukturat përgjegjëse e SRM.

Në pavionet e të sëmurëve infektivë, shpërndërja e ushqimit do të kryhet me material njëpërdorimsh.

Ushqimet që janë gati për konsum do të ndahen në porcione dhe do të shpërndahen në pavione, në oraret e caktuara.

Përgatitja e pjatave, pirunjve, lugëve e tabakave, si dhe pastrimi i mëtejshëm është detyrë e personelit të Kontraktuesit

Vendi i kryerjes së shërbimit (kuzhinës) do të jetë në ambientet e OE.

OPERATORI EKONOMIK DUHET TË KRYEJ :

1-Regjistrim i përditësuar i monitorimeve të HACCP për matjen e shkallës së higjenës së pajisjeve, ambjenteve, personelit dhe pikave kritike nga Përgjegjësit e kuzhinës (P.K)

2-Monitorimi i proceseve të punës të kryera nga personeli të cilat duhet të jenë konform praktikave të mira të higjenës dhe të realizohen me pajisjet e duhura.

3-Kontrolli viziv dhe bakteriologjik në hallka të ndryshme të procesit teknologjik (pikave kritike dhe pikave të kontrollit) duke filluar nga lënda e parë, magazinimi, gatimi, ambalazhimi, transporti dhe deri tek analizat laboratorike vjetore.

4-Kontrolli nga ana e P.K për higjenizimin dhe dezinfektimin korrent të mjedisit, mjeteve të punës dhe transportit me metoda kimike duke përdorur detergjente të përshtatshme të çertifikuar. Gjithashtu kontrolli i ndërhyrjes me metoda fizike për të ç'rrenjosur mbetjet kimike dhe organike në ambjentet e punës.

5-Raportim i përditshëm për infektimin e ambjenteve nga agjentët biologjikë tek DS dhe P.HACCP.

6-Vleresim i emergjencave dhe/ose shkallës së infektimit të strukturës në rast prezence të agjenteve biologjik dhe marrja e vendimit për ndërhyrje të menjëhershme me preparate nga ana e P.HACCP.

7-Ndërhyrje për realizimin e Dezinfektimit dhe/ose deratizimit përkatesisht, të kryhet nga shoqëri të çertifikuara në shërbimin DDD.

8-Mirëmbajtja e mjedisit të brendshëm dhe të jashtëm nga dëmtimet fizike. Pastrimi dhe lyerja periodie e këtyre ambjenteve.

9-Bashkëpunimi me organet e kontrollit të subjekteve jashte kompanisë: Instituti Higjenes, Instituti i sigurisë ushqimore dhe veterinare, Autoriteti i Kontrollit Ushqimor.

10-Kontrolli periodik shëndetësor i personelit për gjendjen shëndetësore të tyre (librezat shëndetësore).

Mos pranimi në punë i punonjësve pa librezë shëndetësore dhe raport të komisionit mjeko ligjor KML.

11-Analizimi vjetor i gjendjes dhe realizimi i detyrave nga secili përfaqësues i grupit.

MARRJA E MOSTRAVE PËR ANALIZAT LABORATORIKE

1.Për qëllim të kontrollit zyrtar të ushqimeve merren mostra të materialeve të papërpunuara të përbërësve, shtesave teknologjike dhe të substancave të tjera, të përdorura për përgatitjen dhe prodhimin e ushqimeve, ushqimeve gjysëm të gatshme, ushqimeve të gatshme, materialeve në kontakt me ushqimet, përfshirë substancat që përdoren për pastrimin dhe mirëmbajtjen në biznesin ushqimor.

2.Operatorët e biznesit ushqimor lejojnë marrjen e sasive të nevojshme të mostrave pa pagesë për kryerjen e analizave, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni.

3.Proçedurat e marrjes së mostrave përcaktohen me urdhër të Ministrit të Bujqësisë.

* Operatorët e biznesit ushqimor janë të detyruar që për ushqimin që ata prodhojnë, të shënojnë, në etiketë dhe/ose në dokumentacionin shoqërues, numrin e regjistrimit.

* Operatorët e biznesit ushqimor e fillojnë veprimtarinë prodhuese dhe tregtuese pasi të jenë pajisur me lejet tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinarë, të dhëna nga AKU-ja. Proçedurat e dhënies së këtyre lejeve përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Bujqësisë.

* Dhënia e lejes përkatëse për fillimin e veprimtarisë së stabilimentit bëhet kur plotësohen kërkesat tekniko-teknologjike, higjieno-sanitare dhe veterinarë për të garantuar sigurinë dhe cilësinë e ushqimeve, në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi, për të mbrojtur shëndetin e konsumatorit. Kërkesat përcaktohen me udhëzim të MB.

NORMAT E SJELLJES PËR NJË PERGATITJE/PËRPUNIM TË SIGURTË TË PRODUKTEVE USHQIMORE.

Për të parandaluar sëmundjet e transmetuara nga produktet ushqimore dhe për të garantuar cilësi dhe siguri të produkteve, është e nevojshme që operatori në përpunimin e produkteve ushqimore, të ndjekë, norma sjelljeje të sakta, që Organizata Botërore e Shëndetësisë ka përmbledhur në DEKALOGUN (10 pikat) në vazhdim, përshtatur nevojave lokale:

1.LARJA E DUARVE VAZHDIMISHT

Duart janë një burim kryesor ndotje, prandaj duhen larë dhe sterilizuar vazhdimisht, në veçanti për:

-çdo ndërhyrje të punës, para se të lyhet në zonën e prodhimit.

-përdorimit të shërbimeve sanitare

-shfryrjes së hundeve ose teshtijes

-prekjes së objekteve, sipërfaqeve, pajisjeve ose pjesëve të trupit (hundë, gojë, flokë, veshë)

2.MBAJTJA E NJË HIGJENE PERSONALE TË PËRPIKTË

Veshjet specifike (kapelja, përparësja e punës, xhaketa, pantallonat, keputët) të ruajtur dhe të veshur në dhomën e veshjes, duhet të përdoren ekskluzivisht gjatë punës, të jenë me ngjyrë të çelët dhe të ndërrohen sapo të bëhen me djersë.

Është veçanërisht e nevojshme kapelja si rezultat i një prezence të lart bakteresh në flokë.

Thonjtë duhen mbajtur të shkurtra dhe të pastra, duke evituar gjatë punës mbajtjen e unazave apo bizhuve të tjera.

3. NDERGJEGJËSIMI PËR GJENDJEN SHËNDETËSORE

Në prani plagësh ose cibanesh, duart duhen dezinfektuar mirë dhe mbuluar me leukoplast ose garzë, që duhen ndërruar vazhdimisht. Në çdo rast punonjësit me plagë të infektuar duhet të ndalohen të prekin ushqime të pjekura ose gati për konsum.

Masa mbrojtëse merren gjithashtu në prezence të simptomave të diareisë dhe temperaturës, duke u vlerësuar me mjekun nëse është i nevojshëm një rekomandim për t'u larguar nga puna.

4. MBROJTJA E USHQIMEVE NGA INSEKTET, BREJTËSIT DHE KAFSHËVE TË TJERA.

Prezencat në ambientet e punës e insekteve ose brejtësve përfaqëson një kërcënim serioz për integritetin e produkteve ushqimore. Parandalimi bëhet duke krijuar barriera të përshtatshme (mbrojtja e dritareve me retina/rrejta të lëvizshme) si dhe me mënyra të përshtatshme në veçanti duke ruajtur ushqimet në mbajtëse të mbyllura mirë dhe duke menaxhuar në mënyrën e duhur mbetjet. Edhe kafshët shtëpiake (qen, mace, zogj, breshka) mbajnë baktere patogjene që mund të kalojnë nga duart tek ushqimi.

5.MBAJTJA PASTËR E TË GJITHA SIPËRFAQEVE

Duke parë lehtësinë me të cilën ushqimet mund të ndoten është e nevojshme që të gjitha sipërfaqet sidomos sipërfaqet e punës, të pastrohen në mënyrë perfekte. Një procedurë korrekte pastrimi

parashikon heqjen e pisllekut, larjen me detergjent, shpërlarjen e parë, disinfektimin të ndjekur nga shpërlarja e fundit dhe tharjen përfundimtare, duke përdorur vetem letër njëpërdorimshe.

6.RESPEKTIMI I TEMPERATURAVE TË KONSERVIMIT

Një konservim korrekt i ushqimeve garanton stabilitetin e tyre dhe redukton mundësinë e përhapjes së mikroorganizmave të dëmshëm për konsumatorin si për shembull:

-Produktet që prishen, të mbuluara me shtresë ose të mbushur me krem me bazë veze, pane, kosi dhe produkte gastronomie me mbulesë xhelatine ushqimore, duhet të konservohen në një temperaturë jo më të lartë se 4°C.

-Ushqimet që prishen lehtë, të pjekura, të cilat duhen konsumuar të ngrohta (si pjata të gatshme, snack, pula me hell, etj), duhet të konservohen në temperaturë nga 60°C deri në 65°C, në banak të veçantë me termostat.

-Ushqimet që prishen lehtë, të cilat duhet të konsumohen të ftohta (si rosto, bifteku, mishi i derrit, etj) dhe brumërat ushqimore të freskëta të mbushura, duhet të konservohen në një temperaturë jo më të lartë se 10°C.

7.TË EVITOHET KONTAKTI I USHQIMEVE KRUDO ME ATO TË PJEKURA

Ushqimet krudo si rezultat i pranisë së mundshme të mikrobeve, mund të ndotin ato të pjekura edhe nëpërmjet kontakteve të vogla: kjo ndotje e kryqezuar mund të jetë direkte por edhe jo e dukshme si në rastin e përdorimit të thikave ose mjeteve prerëse të përdorura njëherë për prerjen e ushqimeve krudo, duke rifitur të njëjtat mikrobe prezente përpara pjekjes. Në konservim duhen mbajtur të ndarë si ushqimet e pjekura dhe ato krudo ashtu dhe tipet e ndryshme të ushqimeve (për shembull të ndahet mishi i derrit nga mishi i gjedhit ose djathi nga proshuta).

8.PJEKJA DHE NGROHJA E USHQIMEVE

Shumë ushqime krudo si mishi, vezët, qumështi jo i pasterizuar, shpesh ndoten nga mikrobe që shkaktojnë sëmundje. Nje pjekje e duhur i shkatërron plotesisht: është thelbësore të respektohet binomi kohë/temperaturë por që mund të varjojnë nga ushqimi në ushqim.

Në ngrohjen e ushqimeve përbën një normë të mirë arritja e 72°C për të paktën dy minuta.

9.PËRDORIMI I UJIT TË PIJSHËM

Mënyrat e degustimit organoleptik janë:

- Vizuale - ngjyra dhe turbullësia
- Shqisor – aroma dhe shija

10. RESPEKTIMI I PLANIT TË VETËKONTROLLIT

Çdo sipërmarrje ushqimore nga më e vogla tek më e madhja duhet të ketë një plan vetëkontrolli në të cilën përshkruhen rreziqet në lidhje me ushqimet dhe masat parandaluese relative, që kompania vë në zbatim për të parandaluar ose mbajtur në kontroll rreziqe të tilla: të paturit dijeni dhe zbatimi i procedurave të përshtatura, është një detyrë dhe obligim për secilin operator.

Kuzhina dhe ushqimi i të sëmurëve.

Kuzhinat e spitaleve ndërtohen në përputhje me numrin e shtretërve të tyre. Për këtë, sipërfaqja e kuzhinës duhet të nxirret duke llogaritur 0.5 m²/shtrat. Kuzhina mund të vendoset në katin përdhës të spitaleve shumëkatëshe dhe duhet të jetë e pajisur me ashensor për ngjitjen/transportin e ushqimeve. Ajo mund të vendoset edhe në një ndërtesë të veçantë, të lidhur me atë të spitalit dhe të ketë mjete të përshtatshme për transportimin e ushqimeve.

Cilësia e ushqimit që marrin të sëmurët varet shumë nga mënyra e organizimit të përgatitjes dhe shpërndarjes së tij. Përgatitja mund të bëhet në mënyrë të përqëndruar dhe ushqimi i gatshëm ndahet në enë të veçanta sipas pavioneve. Ky sistem është më ekonomik (kërkon me pak njerëz) por duhet thënë se kalimi i gjellës së gatshme nga njëra enë në tjetrën shkakton humbjen e yndyrnave dhe pakësimin e kalorazhit (deri në 20%). Nga ana tjetër ushqimi, para se t'i shpërndahet të sëmurëve, duhet ringrohur dhe kjo shkakton shkatërrimin e vitamins C. Në sistemin tjetër ushqimi përgatitet në formë gjysëm të

gatshme në kuzhinën qendrore (blloku i ushimeve) dhe pastaj dërgohet për t'u përgatitur plotësisht në kuzhinat dhe pavionet që e shpërndajnë drejtpërdrejt në pjatat e të sëmurëve.

Sidoqoftë, ushqimi i të semureve të shtruar në spital, veç plotësimit të kërkesave fiziologjike të organizimit, është njëherësh edhe mjet i rëndësishëm terapeutik (mjekues) dhe për rritjen e qëndrueshmërisë së organizimit. Për këtë, ai duhet të përmbajë të gjitha lëndet e nevojshme ushqyese (proteina, yndyrna, karbohidrate, kripëra minerale e vitamina) në sasi të mjaftueshme e në raporte të drejta midis tyre. Përbërja e relacionit ushqimor duhet ti përgjigjet gjëndjes shëndetësore të të semurit. Prandaj lloji i ushqimit për çdo të sëmurë caktohet nga mjeku. Shumë pacientë shpesh herë, për shkaqe që nuk lidhen me semundjen, humbasin oreksin ose nuk i terheq ushqimi, prandaj ai duhet të përgatitet dhe t'u shërbehet atyre me kujdes e në mënyrë tërheqëse.

Shpërndarja:

- 3 herë në ditë:

- Mëngjesi, 07:00-08:00;
- Dreka, 12:00-13:00;
- Darka, 18:00-19:00;

Shtojca 7.*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)*

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT
“SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI, PËR SPITALIN RAJONAL
“MEMORIAL” FIER”

Shërbimi që kërkohet:

| Nr | Përshkrimi | Specifikime | Total 48 mujor |
|---------------|-------------|---|----------------|
| 1 | Dieta Nr.1 | Dieta normale | 43 168 |
| 2 | Dieta Nr 2 | Hidrike B-1 | 54 |
| 3 | Dieta Nr 2 | Hidrike A | 168 |
| 4 | Dieta Nr 2 | Hidrike B-2 | 74 |
| 5 | Dieta Nr.3 | Dieta ne semundjet infektive | 139 |
| 6 | Dieta Nr.4 | Dieta e lenget | 251 |
| 7 | Dieta Nr.5 | Dieta e qullet 1/2 e lenget | 27 694 |
| 8 | Dieta Nr.6 | Dieta ne E hepatopatike ne fazen akute e subakute | 16 |
| 9 | Dieta Nr.7 | Dieta ne hepatopatike | 1 518 |
| 10 | Dieta 8 | Dieta per ulcerozen – Hipo e Normokalorike | 8 |
| 11 | Dieta 8.1 | Normokalorike perdoret ne gastritet hiperacide ne ulcerat gastrike e duodenale ne fazen aktive pa hemoragji dhe ne fazen e cikatrizimit | 8 |
| 12 | Dieta Nr. 9 | Dieta per entero-kolite | 66 |
| 13 | Dieta Nr.10 | Dieta pa gluten | 32 |
| 14 | Dieta Nr.11 | Hipoproteike shume e varfer ne Na 20 gr proteina | 70 |
| 15 | Dieta Nr.12 | Dieta diabetike | 16 271 |
| 16 | Dieta Nr.13 | Dieta diabetikesh e varfer | 2 072 |
| Totali | | | 91 609 |

Afati i ekzekutimit: Do të jetë nga momenti i nënshkrimit të mini-kontratave, sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktor, brenda afatit 48 (dyzet e tetë) muaj nga lidhja e Marrëveshjes Kuadër

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS
“SHËRBIM GATIMI DHE SHPËRNDARJE USHQIMI, PËR SPITALIN RAJONAL
“MEMORIAL” FIER”

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Ofrim i shërbimit sa më cilësor të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes për pacientët e hospitalizuar në shërbimet spitalore të Spitalit Rajonal Memorial Fier.

Detyrat: Përgatitja e ushqimit sipas specifikimeve teknike sipas dietave të përcaktuara nga AK

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambientet e Spitalit Rajonal Memorial, Fier.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. **Ofertuesi duhet të paraqesë:**

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatorët ekonomikë, duhet të disponojnë Licencë të kategorisë “II.1.A.1 - Prodhim, përpunim dhe shpërndarje me shumicë e ushqimeve për njerëz”, (katering). Nuk lejohet përdorimi i Licencës së një operatori tjetër ekonomik (në zbatim të rekomandimit të përbashkët të APP-së dhe AKU-së të datës 19.11.2018).

2.1.2 Operatorët ekonomikë, duhet të posedojnë të paktën 1 (një) stabiliment të licensuar për prodhimin e ushqimit. Ky stabiliment duhet të jetë brenda bashkisë ku do të zbatohet marrëveshja kuadër. Objekti mund të jetë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik duhet të paraqesë aktin e pronësisë ose kontratë qiraje ose përdorimi, ku të identifikohet dhe vendndodhja brenda bashkisë.

2.1.3 Operatorët ekonomikë, duhet të paraqesin një deklaratë se nga kontrolli i fundit i realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë Aktin e kontrollit të fundit të realizuar nga Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU), ku ka rezultuar se ushtron aktivitet konform kërkesave ligjore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e fondit limit të marrëveshjes kuadër.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare (2023, 2024, 2025), të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41 të Ligjit Nr. 10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 39 % të vlerës së fondit të limit të marrëveshjes kuadër.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se disponon dhe të paraqesë çertifikatë (të vlefshme), si më poshtë:

SSH/UNI/DIN/EN ISO 22000 mbi “Sistemet e menaxhimit të sigurisë ushqimore”, ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001 mbi “Sistemet e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” ose ekuivalente/ të barazvlefshme;

SSH/UNI/DIN/EN ISO 14001 “Sisteme të menaxhimit të mjedisit” ose ekuivalente/të barazvlefshme;

2.3.3 Operatorët ekonomikë, për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes së ushqimit, objekt prokurimi duhet të kenë jo më pak se 13 (trembëdhjetë) persona të punësuar, sipas profesioneve në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Profesioni | Numri i punonjësve |
|-----|---|--------------------------|
| 1. | Drejtues Teknik/ Përgjegjës Shërbimi Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor) | 1 (një) |
| 2. | Kuzhinier | 1(një) |
| 3. | Ndihmës Kuzhinier | 1(një) |
| 4. | Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK | 9 (nëntë) |
| 5. | Shofer | 1 (një) |
| | Total | 13 (trembëdhjetë) |

Për punonjësit e kërkuar në këtë kriter, duhet të paraqiten dokumentat:

Listëpagesën e sigurimeve shoqërore dhe tatimit të ardhurave nga punësimi (E-Sig) të konfirmuar nga organet tatimore për muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, për Mercolog/Kimist/Teknolog Ushqimor (Agroushqimor), Kuzhinierin, Ndihmës Kuzhinierin, Punonjës shpërndarës ushqimesh në ambientet e AK.

a) **Drejtues Teknik/ Përgjegjës Shërbimi: Mercolog/Kimist/ Teknolog Ushqimor (Agroushqimor):**

- Diplomë me profesionin perkates;
- Kontratë pune (e vlefshme),

-
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite;
 - CV

b) Për Kuzhinierin:

- Diplomë ose certifikatë kualifikimi për kuzhinier në përputhje me Ligjin për Arsimin dhe Formimin Profesional,
- Kontratë pune si kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 2 dy vite.
- CV

c) Për ndihmës kuzhinierin:

- Kontratë pune si ndihmës kuzhinier, (e vlefshme)
- Librezë pune/ deklaratë e kontributeve të sigurimeve shoqërore individuale e lëshuar nga e – albania/ çdo dokumentacion tjetër që vërteton eksperiencën në shërbime të ngjashme, jo më pak se 1 një vit
- CV.

d) Për punonjësit për shpërndarje ushqimi të paraqitet:

- Kontratë pune si shpërndarës ushqimi (e vlefshme).

dh) Për punonjësit Shofer, të paraqitet:

- Kontratë pune si shofer, (e vlefshme)
- Leje Drejtimi, për mjetin e kërkuar, në përputhje me Legjislacionin në fuqi

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë minimumi 1 (një) mjet transporti frigoriferik, për transportin e produkteve ushqimore. Mjeti mund të jenë në pronësi, qira apo përdorim sipas rregullimeve ligjore.

Për të vërtetuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin: dokumentacion të plotë si akti që vërteton pronësinë, kontratë qiraje/përdorimi/shërbimi, dhe leje qarkullimi, policë sigurimi, certifikatë kontrolli teknik, taksa vjetore si dhe të jetë i shoqëruar me certifikatë higjeno- sanitare (të vlefshme).

Ky Kriter konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 10 të DT. Dokumentet provuese të kërkuara më sipër, do të paraqiten nga ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga Autoriteti Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

